



01-2203

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p>PRISHTINA</p> 
---	--	--

Në bazë të nenit 21, 22, 44 dhe 84 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-271790/22 dt. 19.12.2022, të pronarëve Refik, Xhavit dhe Afrim Sadiku nga Prishtina dhe investitorit “Skandinavian Construction” Sh.p.k. me adresë në rrugën “Muharrem Fejza”, Lagja Mati 1, Prishtinë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik urban “C-9” të tërësisë urbane “C”, të Planit Rregullues “Mati 1”, në rrugën “Faton Shabani” dhe “Fatime Xhaka” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 24.01.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Refik, Xhavit dhe Afrim Sadiku nga Prishtina, me investitor “Skandinavian Construction” Sh.p.k. me adresë në rrugën “Muharrem Fejza”, Lagja Mati 1, Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810837403, me përfaqësues Avdi Hasani, sipas kërkesës 05 Nr.391/02-271790/22 dt. 19.12.2022, përdorimi i kompleksit të ndërtesave shumë banesore me afarizëm, të emërtuar si “Ndërtesa 1” me etazhitet 2B+P+6ET, “Ndërtesa 2” me etazhitet 2B+P+5ET dhe “Ndërtesa 3” me etazhitet 2B+P+6ET, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-147813 dt. 10.08.2015, në kuadër të bllokut urban “C-9” të tërësisë urbane “C” të Planit Rregullues “Mati 1” konkretisht në parcelën kadastrale nr. 01556-0, ZK Matiçan.

II. Ndërtesat nga pika I. e këtij vendimi, ndodhen në rrugët “Fatime Xhaka” ku kanë dalje hyrjet e këtyre ndërtesave me numrat: 17, 19, 21, 23, 25, 29, 33, 37 dhe 39 dhe “Faton Shabani” 90, 92, 94, 96, 98, 100 dhe 102 në Prishtinë, dhe të njëjtat do të përdoren dhe shfrytëzohen sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesave dhe njësive të tyre në evidencat e regjistrimit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.



A r s y e t i m

Pronarët Refik, Xhavit dhe Afrim Sadiku nga Prishtina dhe investitorët Skandinavian Construction” Sh.p.k. me adresë në rrugën “Muharrem Fejza”, Lagja Mati 1, Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 810837403, me përfaqësues Avdi Hasani, me kërkesën me 05 Nr.391/02-271790/22 dt. 19.12.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për kompleksin e ndërtesave shumë banesore me afarizëm, të emërtuar si “Ndërtesa 1” me etazhitet 2B+P+6ET, “Ndërtesa 2” me etazhitet 2B+P+5ET dhe “Ndërtesa 3” me etazhitet 2B+P+6ET, të ndërtuara në kuadër të bllokut urban “C-9” të tërësisë urbane “C” të Planit Rregullues “Mati 1” konkretisht në parcelën kadastrale nr. 01556-0, ZK Matiçan, ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351-147813 dt. 10.08.2015 të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë, me referencë 09 Nr. 391/02-56751/22 dt. 16.12.2022, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimin mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimin të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuessit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i punishtes Dren Rukiqi; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Besarta Suma; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Arif Rukiqi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Ibrahim Lekaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Nexhmedin Durmishi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Agron Pajaziti; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Labinot Dedushi, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar për kryerjen e matjeve kadastrale Myzafer Mustafa me nr. të licencës 09;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesat shumë banesore me afarizëm mund të përdoren.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e



certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesat shumë banesore me afarizëm mund të përdoren, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-271790/22 DT. 24.01.2024**

Zyrtari,
Berim Osmanaj

Udhëheqëse e Sektorit
Nazirë Krasniqi



